

Formular Syllabus – Pikturë1

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Arteve
Departamenti	DAD - DIZAJN SKENE DHE KOSTUMOGRAFI
Titulli i lëndës:	Pikturë 1
Niveli:	<u>Bachelor</u>
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I, Semestri I – II
Numri i orëve në javë:	L. 3 (tre), U. 1 (një)
Vlera në kredi – ECTS:	3
Koha / lokacioni:	E martë, (L) 12:00-14:30 dhe 11:00-11:45 (U)
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.asst.dr. Zeni Ballazhi
Detajet kontaktuese:	+383 44 200219 zeni.ballazhi@uni-pr.edu

Përshkrimi i lëndës	<p>Lënda “Pikturë 1” ka një strukturim stabil dhe të përgjithshëm, që specifikohet në forma të ndryshme trajtimi: në kohë, hapësirë, dhe zhanre të medimeve të ndryshme teknike të pikturës: natyra të qeta, anatomia, figura, peisazhe dhe kompozicione në enterier dhe eksterier.</p> <p>Punohet me çdo student veç e veç gjatë studimit; praktik-teori, vërejtje, këshilla, sugjerime etj. lidhur me natyrën e realizimit sa më të suksesshme të punës. Analizë kronologjike rreth veprave artistike të ngjashme sipas historisë së artit vendor dhe botëror.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Njoftimi i studentëve me nevojat e materialit të lëndës së pikturës për vitin e parë.</p> <p>Materialet e nevojshme; ngjyra akrilik ose të vajit, brusha speciale për teknikat e caktuara, letër speciale dhe pëlhurë të gatshme, të përgatitur për fillimin e punës, pëlhurë apo leckë çarçafi që përdoren gjatë procesit të punës si dhe pastrimin e brushave, ose një gotë për ujë nëse punohet me ngjyra akrilik, kurse për ngjyra vaji terpeninë apo vaj special për përzierjen dhe shkrirjen e ngjyrave, dhe natyrisht paletën për ndrydhjen e ngjyrave nga tubat.</p> <p>Njoftim me mënyrën e punës dhe përdorimin me teknikat e pikturimit përmes këtyre ngjyrave.</p>

	<p>Studentët punojnë sipas aftësisë së tyre drejtpërdrejt me ngjyrë, ose paraprakisht motivi dhe idetë e punës parapërgatiten me skica, me laps apo me ndonjë element tjetër në tekniken e realizimit të punës.</p> <p>Skicat e shpejta (që shkathtësojnë studentët në kapjen e shpejtë të natyrave të qeta, portretit, kompozicionit dhe figurës përmes së cilave perfeksionojnë linjat më të çliuruara si dhe avancimi i studimit në krahasim me studimin që kërkon më tepër vëmendje, kërkesë dhe analizë).</p> <p>Gjithashtu aftësimi studentëve për t'i lënë të lirë në shprehjen e imagjinatës së tyre, përveç punës me natyra të qeta, e cila bënë që të jenë të përgatitur për të bërë punime përmes ndjenjës dhe imagjinatës.</p>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Perceptimi i figurës në hapësirë dhe në pikturë. Zhvillimi i aftësisë kompozicionale. Proporcioni i figurës në komponim me natyrën. Balancimi i hije –dritës në shërbim të formës dhe të ngjyrës; në natyrë të qetë, portret, figurë, peizazh apo edhe në ndonjë realizim të artit bashkëkohor si; video art, instilacion, përformancë etj. Studimi i formës dhe materializimit në kompozicion dhe ngjyrë.</p> <p>Aftësia e studentit në vlerësimin e punës, çka dhe sa ka arritur me punën e tij. Gjithashtu analizë, kritikë, vetëkritikë dhe debat rreth punës.</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	30 Javë	90
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kolokfiume, seminare			
Detyra të shtëpisë	1	30 Javë	30
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në			

shtëpi)			
Përgatitja përfundimtare për provim	5	3 Javë	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)			
Projektet, prezantimet, etj	5	3 Javë	15
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:			
	<p>Puna praktike në klasë. Puna teorike. Instruktim dhe ligjërata në fillim të orës, për atë që duhet të arrihet nga studentët për këtë detyrë. Korrekturë, analizë, konsultë, demonstrim gjatë orës në punë individuale me secilin student gjatë zhvillimit të procesit të punës. Realizimi i punës kryesisht në studio-atelie. Kontrollimi i detyrave të realizuara jashtë procesit mësimor. Diskutim, vlerësim i orës së mësimit dhe detyrës së realizuar. Analizë kronologjike rreth veprave artistike të ngjashme sipas historisë së artit vendor dhe botëror.</p>		
Metodat e vlerësimit: Sistemi i vlerësimit me pike	<p>Nën <50 pikë – vlerësohet me notë jo kaluese >50 – <60 pikë – vlerësohet me notën (6) >60 – <70 pikë – vlerësohet me notën (7) >70 – <80 pikë – vlerësohet me notën (8) >80 – <90 pikë – vlerësohet me notën (9) >90 pikë – vlerësohet me notën (10)</p> <p>Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë: 30% Vijimi i rregullt : 10% Provimi final: 30% Totali; 100%</p>		
Literatura			
Literatura bazë:	<p>Histori e artit botëror dhe vendor si dhe analizë e autorëve të ndryshëm. Kritika dhe vështrime estetike (material i përzgjedhur individualisht sipas kërkesave të studentit). Informacione nëpërmjet mediumeve të ndryshme</p>		

	<p>për të rejat në art. Informacioni bazë nga biblioteka e Fakultetit të Arteve, nga autori; E .H.Gombrich, The Story of Art, botimi në shqip Soros; etj...si dhe botime (katalogje) nga autor vendor për artet pamore.</p>
Literatura shtesë:	<p>Historia e artit modern: Lëvizjet më me influencë të "artit modern" dhe përfaqësuesit kryesorë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • (1) Impresionizmi (1870s, 1880s) • (2) Fauvizmi (1905-7); • (3) Kubizmi (1908-14); • (4) Futurizmi (1909-14); • (5) Ekspresionizmi (nga 1905); • (6) Dadaizmi (1916-24); • (7) Surrealizmi (nga 1924); • (8) Ekspresionizmi Abstrakt (1948-60); dhe • (9) Pop Arti (1950, 1960).
Plani i dizajnuar i mësimi: Viti i Parë (Semestri i parë)	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	<p>Prezantim i lëndës. Diskutim mbi planprogramin e lëndës, rrjedhen e ligjeratave dhe bibliografine e nevojshme. Trajtimi i temave dhe motiveve Punë praktike rreth këtyre diskutimeve (3 orë)</p>
Java e dytë:	<p>Materialet dhe teknikat e punës. Pikturimi tonik: “natyrë e qetë” (analizë dhe skicime) Vazhdim i punës praktike dhe sugjerime (3 orë)</p>
Java e tretë:	<p>Pikturim me ngjyra: “natyrë e qetë” - kompozicioni Diskutim për figurat, format dhe hapësirën gjatë punës praktike (3 orë)</p>
Java e katërt:	<p>Analizë e punës rreth pikturimit tonik në “natyrën e qetë” Analizë e punës rreth pikturimit me ngjyra (3 orë)</p>
Java e pestë:	<p>Pikturimi i portretit (studim sipas modelit) dhe “Natyrës së qetë” me një ngjyrë; të ujit apo temper Interpretim ngjyrash në studimin e portretit dhe “natyrës së qetë” (3 orë)</p>
Java e gjashtë:	<p>Studimi i figurës-pikturë sipas modelit Studim akademik – analitik (teori-praktikë), (3 orë)</p>
Java e shtatë:	<p>Natyrë e qetë – variacioni i toneve dhe harmonia e ngjyrave Natyrë e qetë – variacioni i toneve dhe ngjyrave –vazhdim</p>

	nga ora e kaluar (3 orë)
Java e tetë:	Peizazhe sipas të vërejturit real në natyrë ose nga reproduksionet Analizë dhe vërejtje në vazhdimësi te punimit; prof.-student (2orë)
Java e nëntë:	Perspektiva lineare në natyrë të qetë përmes ngjyrës Studim gjatë punës me student, (3 orë)
Java e dhjetë:	Peizazhe në kompozicion me portretin Vazhdim nga ora e kaluar (3 orë)
Java e njëmbëdhjetë:	Peizazhe në kompozim me figurën Vazhdim nga ora e kaluar (3 orë)
Java e dymbëdhjetë:	Analizë rreth materializimit të figurës me kompozicionin në peizazh – figurat abstrakte Vazhdim i punës nga ora e kaluar (3 orë)
Java e trembëdhjetë:	Peizazhe ngjyrash sipas imagjinatës – kompozicioni abstrakt Vazhdim i punës nga njësia e kaluar (3 orë)
Java e katërbëdhjetë:	Analizë dhe kritikë individuale dhe grupore e punës së portretit dhe figurës (problemet e kompozicionit në mes figurës dhe formës së ngjyrave) Natyrë e qetë dhe problemet e perspektivës -analizë (3 orë)
Java e pesëmbëdhjetë:	Prezantimi i punës semestrale; vetë-kritikë dhe analizë Diskutim rreth mundësisë së organizimit të ndonjë ekskursioni me karakter studiues gjatë pushimit dimëror dhe vizta të institucioneve të ngjashme (Galeri, Muze, Teatër, Kinema etj. (3 orë)

Plani i dizajnuar i mësimi: Viti i parë (Semestri i dytë)	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Kontrasti i figurave dhe elementeve në natyrë të qetë Figura me elemente të tjera si shprehje qenësore (3 orë)
Java e dytë:	Harmonia e formave dhe ngjyrave në kompozicion Harmonia e formës në hapësirë përmes ngjyrës (3 orë)
Java e tretë:	Konkretizimi material dhe kompozicional i punës Problemet e kompozicionit, diskutim dhe analizë nga ora e kaluar (3 orë)
Java e katërt:	Pikturimi sipas imagjinatës (temë e lirë) Vazhdim nga ora e kaluar, diskutim, vërejtje, bashkëbisedim (3 orë)
Java e pestë:	Figura në kompozicionin imagjinues Vërejtje, sugjerime, diskutime rreth punës nga ora e kaluar

		(2 orë)
Java e gjashtë:	Variacione ngjyrash në pikturë (teori-praktikë) Bashkëbisedim për temën nga ora e kaluar	(3 orë)
Java e shtatë:	Kompozicioni dhe elemente të tjera Vazhdim i punimit nga ora e kaluar	(3 orë)
Java e tetë:	Kompozicioni në figurë, formë dhe elemente të tjera Kontrasti i ngjyrës në kompozicion (teori-praktik)	(3 orë)
Java e nëntë:	Përfundimi i punimit Studim dhe analizë	(3 orë)
Java e dhjetë:	Studimi i valerit në pikturë (kompozicion) Vazhdim nga ora e kaluar	(3 orë)
Java e njëmbëdhjetë:	Kompozicion sipas imagjinatës Vazhdim i punës nga ora e kaluar	(3 orë)
Java e dymbëdhjetë:	Kompozicion me forma të çrregulluara Analizë dhe studim i kompozicionit	(3 ore)
Java e trembëdhjetë:	Vizitë; Galerisë Kombëtare të Kosovës, Diskutim i lirë dhe analizë rreth punëve të ekspozuara	(3 ore)
Java e katërbëdhjetë:	Analizë dhe kritikë individuale dhe grupore rreth punës së përfunduar brenda vitit	(3 orë)
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi dhe përgatitja e punimeve për organizimin e ekspozitës	(3 orë)

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Mosangazhimi, vonimi dhe mosintersimi retroaktiv në ligjerata.
Përdorimi i celulareve etj, do të rezultojë me humbje të pikëve, për shkak të sjelljes joprofesionale.
Zbatimi me korrektesi i orarit të mbarimit të mesimit.